

albinfo.ch

DEBAT ME DIASPORËN SHQIPTARE NË ZVICËR **MAQEDONIA NË PRAG TË ZGJEDHJEVE: NDRYSHIMET, ILUZION APO REALITET?**

ME PREZENCËN E DY KRYEBASHKIAKËVE
DHE Oponentëve politikë

ZIADIN SELA

KRYETAR I STRUGËS, KRYETAR I LËVIZJES PËR REFORMA -
PARTIA DEMOKRATIKE SHQIPTARE (LR-PDSH)

ZORAN ZAEV

KRYETAR I STRUMICËS, KRYETAR I PARTISË
SOCIAL-DEMOKRATE TË MAQEDONISË (SDSM)

MODERIMI

ANDREAS GROSS

ISH-KËSHILLTAR NACIONAL ZVICERAN,
SPECIALIST I DEMOKRACISË KONSENSUALE

DR. BASHKIM ISENI

POLITOLOG, DREJTOR I ALBINFO.CH

**E DIEL, 13 NËNTOR • ORA 15.00-17.00 • BERNË, HOTEL BERN
ADRESA: ZEUGHAUSGASSE 9 • 3011 BERN**

albinfo.ch

Pas skandaleve të përgjimeve të dala në opinion të ushtruesve të pushtetit në Maqedoni nga radhët e VMRO-DPMNE-s, BDI-së, si dhe PDSH-së dhe arritjes, me ndërmjetësim të Unionit Evropian, të Marrëveshjes së Përzahinos më 15 korrik 2015 mes liderëve politikë maqedonas dhe shqiptarë për krijimin e një qeverie teknike dhe organizimin e zgjedhjeve të reja, të cilat do të mbahen më 11 dhjetor 2016.

Në këtë proces zgjedhor po ashtu janë të mobilizuar edhe shtetasit e Maqedonisë në diasporë që gëzojnë të drejtë teorike vote në këtë proces, sepse ata zyrtarisht mund të votojnë nëpër Ambasada të Maqedonisë, ose në vendlindje. Me qëllim të krijimit të një hapësire demokratike debati dhe informimi të mirëfilltë të diasporës shqiptare të Maqedonisë si dhe involvimin e saj në zgjedhjet në Maqedoni, Albinfo.ch organizon debat mbi situatën që zotëron atje, se çka është në lojë dhe cilat janë pritjet, por edhe kërkesat e diasporës shqiptare të Maqedonisë mbi këto zgjedhje.

Për të kultivuar një cikël të debateve argumentuese të mirëfillta, Albinfo.ch ka ftuar në këtë tryezë të parë dy figura politike opozitare që janë ushtrues pushteti në nivel lokal, por që janë po ashtu oponentë politikë në nivel qendror, respektivisht:

Zoran Zaev, kryetar i partisë SDSM, kryebashkiak i Strumicës, figurë opozitare që nxori në shesh një sërë skandalesh të përgjegjësve politikë maqedonas mbi afëra korruptive dhe nepotizmi në nivelet më të larta të shtetit, por edhe mbi instrumentalizimin ndëretnik. Zoran Zaev angazhohet për ndryshim rrënjësor të lidërshtpit politik në Maqedoni si dhe orientimit politik të këtij shteti, duke e tejkalluar modelin etnik, për t'u drejtuar drejt një Maqedonie qytetare.

Ziadin Sela, kryetar i Strugës, deputet i listës LR-PDSH dhe figurë politike me peshë në jetën politike të Maqedonisë, i cili drejton kritika të hapura ndaj përgjegjësve politikë në pushtet, sikurse atyre maqedonas, ashtu edhe atyre shqiptarë, dhe atë sikurse në planin e transparencës si dhe në përmbushjen e të drejtave politike kolektive të shqiptarëve në Maqedoni.

Me qëllim që diaspora të ketë elemente informimi që do ta ndihmojnë ta përcaktojë votën e saj, debati do të orientohet kryesisht në 3 boshte:

- Ku qëndron problemi i Maqedonisë, sikur në planin e krizës së legjitimitetit të udhëheqësisë si dhe krizave ndëretnike që riciklohen periodikisht? Si mendohet konkretisht të sillen ndryshimet e premtuara që demokracia, pavarësia e gjykatës, por edhe përgjegjësia politike të vihen në shërbim të qytetarëve të vendit? Sa këto ambicie dhe premtime reflektohen konkretisht në komunat që këta liderë i udhëheqin? Si do t'i tejkalojnë barrierat që do të mund t'iu shtrohen nga ushtruesit e pushtetit aktual në Maqedoni, të zhytur thellë në keqpërdorime të resurseve të vendit dhe kapjen e shtetit? A mos është naivitet të mendohet në ndryshime civilizuese dhe paqësore politike karshi një situatë ku humbja e pushtetit nënkupton më vonë ballafaqim me organet e drejtësisë?
- Sa opozita maqedonase, por edhe ajo shqiptare, do t'u përkushtohen seriozisht zgjidhjes serioze të çështjes shqiptare në Maqedoni dhe atë sikurse për nga ana e të drejtave të tyre kolektive politike (sidomos çështja e statusit zyrtar të gjuhës shqipe dhe krijimit të institucioneve politike që reflektojnë realitetin multientik të saj), si dhe zhvillimit ekonomik (ndarja po ashtu e resurseve shtetërore për zhvillimin e hapësirave shqiptare të Maqedonisë)? Cilat janë opsionet e tyre, dhe mos ato janë vetëm retorikë zgjedhore? Çka konkretisht ata do të ndërmarrin për arritjen e një ujdje historike në planin e bashkëjetesës ndëretnike?
- Cilën rrugë do ta ndjekë Maqedonia sa i përket orientimeve strategjike globale? Sa ky vend do të arrijë të rreshtohet në frymën dhe rrugën evropiane? Sa vendet perëndimore janë duke e ndihmuar ndryshimin e mënyrës së udhëheqjes së këtij vendi? Kush nga jashtë e ndihmon ngecjen e këtyre proceseve? Cilat janë zgjidhjet dhe opsionet që propozohen?

KOMENTE HYRËSE DHE SINTEZË E DEBATIT, ME THEKS TË VEÇANTË MBI DEMOKRACINË KONCENSUALE DHE PËRGJEGJËSINË POLITIKE.

GJUHA E DEBATIT: SHQIP, ME PËRKTHIME SIMULTANE NGA MAQEDONISHTJA DHE ANGLISHTJA.

**HYRJA GRATIS
JENI TË MIRËSEARDHUR !**